



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Direktorat za Budžet i Finansije

Data/Datum/Date:	19.08.2025
Nr./Br./No	11/129
Për/Za/To:	Komiteti per Politik dhe Financa Kuvendi Komunal Shtime
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Besnik Ahmeti; Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Znj. Kimete Ukaj; ZKF; Komuna e Shtimes
Lënda/Predmet/Subject :	Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2024 për Komunën e Shtimes nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Të nderuar,


Më lejoni që përmes kësaj shkrese të iu njoftoj për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2024 për Komunën e Shtimes të kryera nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Të bashkangjitur gjeni dokumentin e raportit.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit kishte realizuar pagesa në vlerë 461,764€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtimes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në pesë (5) raste në vlerë 34,482€ komuna kishte vonesa në pagesën e obligimeve financiare nga 30 ditë deri në 455 ditë.
- A2 Në një (1) rast kishte vonesa në realizimin e projekteve kapitale.
- B2 Në dy (2) raste komuna kishte ndarë subvencione pa respektuar kriteret e thirrjes publike.
- A3 Mos mbyllja e investimeve në vijim.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtimes .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtimes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtimes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtimes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtimes .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura.

Vlenë të theksohet se gjatë vitit 2024, ishin realizuar pagesa nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore në vlerë 868,505€ për kontratën kolektive nga kjo shumë borxhi bazë ishte 539,770€, kurse shpenzimet shtesë përmbarimore ishin 328,735€.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja	Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”. nenit 18 pikës 3 të Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë. Në bazë të pagesave të testuara, kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuate, në vlerë prej 461,764€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor/të gjykatës për paga jubilarë, shujta dhe kualifikim për arsimtar nga kategoria investimet kapitale 278,840€, nga mallra shërbime dhe komunal 132,209€ dhe nga Subvencione dhe transfere 50,716€. Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në kategoritë përkatës ekonomike.
Ndikimi	Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.
Rekomandimi B1	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.
Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)	

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare

Gjetja

Sipas LMFP-së Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit neni 39 përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Në pesë (5) raste, faturat në vlerë totale prej 34,482€, kanë të bëjnë me obligime të papaguara, duket tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditë, ku vonesat janë deri në 453 ditë. Këto fatura kanë të bëjnë me: shërbimet fotografike për aktivitete (1,378€), furnizim me ushqim dhe pije me rastin e organizimit të festave nga Komuna (479€ dhe 990€), zbatimin e masave të efikasitetit (15,050€), dhe obligimet përmes vendimit gjyqësor për pagane (16,584€).

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, ku nuk ka pasur planifikim të duhur të buxhetit për këto obligime.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave në pagesën e faturave, komuna mund të përballlet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat e shkaktuara të kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Vonesa në realizimin e projektit kapitale

Gjetja

Sipas Rregullës Nr. 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23 menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Në bazë të mostrave të testuara në një (1) rast kemi vërejtur se punimet nuk ishin realizuar konform planit dinamik siç parashihej me kontratë, ku:

- Kontrata "Rregullimi i murit mbrojtës në Reçak afer Kompleksit dhe asfaltimi i rrugëve rr. 15 Janari rr. Pavarsia, kanalizimi në rr. Deshmoret e Reçakut-Ri-Tenderim" në vlerë 69.435€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 11 muaj.

Vonesa për këtë kontratë ishte 40 ditë.

Mangësitë e identifikuara kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të projektit për tu siguruar që projekti të realizohet sipas planit dinamik.

Ndikimi	Vonesat në realizimin e projektit ndikojnë në mos arritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të projektit të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.
Rekomandimi A2	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Ndarja e subvencioneve duke mos respektuar kriteret e thirrjes publike dhe mos raportimi sipas kërkesave ligjore

Gjetja	Sipas nenit 23 paragrafi 2 Rregullorja MF-Nr.04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), Përfituesi raporton te zyrtari monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës së përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin. Neni 4 i kontratës ndemjet komunës dhe përfituesit e obligon përfituesin të përgatit raportin financiar për mjetet e shpenzuara dhe raportin narrativ për aktivitetet e realizuara si dhe të gjitha shpenzimet me vlerë mbi 500 duhet të bëhen vetëm përmes transferit bankar. Po ashtu thirrja publike Nr.09/34 e datës 16.02.2024 për mbështetje financiare për projektet në zhvillimin dhe masivizimin e sportit përcakton kriteret për aplikim.
--------	---

Komuna gjatë viti 2024 kishte ndarë subvencione për mbështetjen e "OJQ-ve, Klubeve sportive të Futbollit, Futsallit dhe për aktivitete kulturore/ansamble" në vlerë prej 34,800€, këto aktivitete kanë të bëjnë me përkrahjen e klubeve në gara të ndryshme sportive dhe ansambleve në aktivitete kulturore. Mbështetja financiare për klubet e Futbollit në vlerë 20,000€, Futsallit në vlerë 10,000€ dhe Ansamblit të këngëve dhe valleve në vlerë 4,800€.

Gjatë testimit të mostrave kemi vërejtur se dy (2) OJQ/Klube sportive kanë përfituar subvencione pa plotësuar kriteret e thirrjes publike.

- Klubi i Futsallit mungojnë vërtetimi i kryerjes së obligimeve tatimore, projekt-propozimi, është dorëzuar projekt propozimi i vitit 2023, deklarata e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burime tjera, Deklarata që tregon se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetja financiare publike e mëhershme dhe CV e menaxherit të projektit.
- Klubi i futbollit mungojnë vërtetimi i kryerjes së obligimeve tatimore dhe CV e menaxherit të projektit.
- Në dy (2) raste janë identifikuar raportime të parregullta nga përfituesit e subvencioneve "OJQ-Klubi i futbollit", dhe OJQ-Ansamblit i këngëve dhe valleve raportet financiare dhe narrative nuk janë sipas kërkesave të përcaktuara me rregulloren përkatëse.
- Klubi i Futsallit për dy (2) fatura mbi 500€ nuk janë bërë me transferim si kërkohej me kontratë dhe raporti narrativ jo sipas

rregullores i cili nuk përshkruan aktivitet e realizuara.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me subvencionimin e OJQ-ve.

Ndikimi

Mos plotësimi i kriterëve nga përfituesit e subvencioneve, si dhe mos dorëzimi i raporteve narrative dhe financiare për periudhat raportuese, ndikon negativisht dhe krijon vështirësi në menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve të respektohen kriteret e thirrjes publike, dhe OJQ-të përfituese të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos mbyllja e investimeve në vijim

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 02/2013 "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Sipas analizës së regjistrit kontabël të pasurive kapitale është vërejtur se në kuadër të kodit ekonomik "32500 Investimet në vijim" nuk janë mbyllur projektet të cilat janë finalizuar, ku nga viti 2016 deri në vitin 2020 ishin në vlerë prej 630,056€.

Mangësitë e identifikuar kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive kapitale.

Ndikimi

Mos mbyllja e investimeve në vijim shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që ka në dispozicion komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe do të rezultojë në prezantimin jo të drejtë dhe të plotë të informatave në PVF.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasurit në vijim të regjistruara në regjistra kontabël të komunës janë mbyllur dhe të regjistrohen si pasuri sipas klasave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2024 ishin në vlerë 558,033€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 206,304€ (gjobat në trafik 206,102€ dhe të hyrat nga agjencioni i pyjeve në shumë prej 202€).

Çështja A4 - Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja	Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t’i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”. Komuna kishte përgatitur raporte të rregullta gjashtë (6) mujore, mirëpo këto raporte nuk përmbanin informata lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Edhe në vitin 2024, komuna kishte lidhur katër (4) kontrata të reja për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale si dhe kishte ripërtërirë tri (3) kontrata tjera, por nuk kishte raportuar për qëllimin e dhënies në shfrytëzim dhe mbikëqyrjes së tyre. Kjo vjen si rezultat i kontroleve të brendshme jo efikase, mos përgjegjësisë së zyrtarëve përkatës të komunës për të zbatuar kërkesat e ligjore në lidhje me shfrytëzimin pronave komunale nga qiramarrësit.
Ndikimi	Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore po ashtu ndikon në realizimin e plotë të të hyrave.
Rekomandimi A4	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimit në pronë

- Gjetja** Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.
- Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.
- Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë është identifikuar se 7,883 tatimpagues individual nuk kanë të prezantuar numrat personal në këtë bazë.
- Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë nga njësia komunale e tatimit në pronë.
- Ndikimi** Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat identifikues personal të tatimpaguesve paraqet mangësi dhe potencialisht mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor.
- Rekomandimi A5** Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,241,492€, prej tyre ishin shpenzuar 3,047,445€ apo 94%. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, objektet arsimore, mirëmbajtje investive, ujësjellësve, kanalizimeve, pajisje etj.

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja Sipas të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 pika (f) parasheh se menaxherët e kontratës "Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Në bazë të mostrave të testuara, në pesë (5) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si:

- Rregullimi i Tregut të Hapur në Qytetin e Shtimes-Faza II në vlerë 299.584€.
- Kanalizimi në zonën e Biznesit në komunën e Shtimes-Ri tenderim në vlerë 43.094€.
- Asfaltimi i rrugëve trotuareve dhe ndriçimit në Rashincë Rr.Cani,rr Burimi, rr.Ferizajit, rr. Beqir Rushiti, rr.Trimat e Lirise, rr. Qorrolli në vlerë 66.228€.
- Ndërtimi i sallës sportive në fshatin Zborc dhe Reçak - Faza II në vlerë 223.291€.
- Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i ndriçimit ne Vojnovc seg rr. Jashari, rr.Ulqini, rr. Mehmeti rr.Bashkim Emini në vlerë 69.641€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit e lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin/performancën e kontratave.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2024 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 843,377€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 842,430€ dhe taksat nga qiraja në vlerë 947€.

Çështja B4 - Efikasiteti i ulët në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenin 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr. 06/L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Në krahasim me vitin paraprak, Llogaritë e arkëtueshme në vitin 2024 janë rritur për 328,874€ apo rreth 64%. Sfida kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë dhe atë për vitet paraprake, edhe përkundër faktit që komuna gjatë vitit 2024 kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme duke dërguar letër rikujtimin për detyrimet e papaguara tek tatimpaguesit, komuna nuk kishte ndërmarrë masa shtesë konkrete (përveç letër rikujtimit) si ajo e veprimeve ligjore përmes përmbaruesit për mbledhjen/realizimin e llogarive të arkëtueshme.

Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave dhe mungesa e marrjes së veprimeve të nevojshme për inkasimin e tyre ka efekt negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake. Gjithashtu, mungesa e veprimeve të mjaftueshme për mbledhjen e të hyrave ndikon në rritjen e rrezikut të vjetërsimit të llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur mekanizma adekuat me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	10,200,510	11,361,030	11,041,411	9,376,389	7,702,313
Grante Qeveritare - Buxheti	9,337,119	9,661,531	9,532,757	8,616,369	6,582,714
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	68,484
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	293,691	293,691	175,933	0	308,363
Të bartura nga viti i kaluar	0	628,753	583,502	273,758	261,935
Të hyrat vetanake	569,700	569,700	543,139	486,262	470,826
Donacionet vendore	0	1,203	0	0	9,864
Donacionet e jashtme	0	206,152	206,080	0	125

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,160,520€. Kjo rritje ishte nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 628,753€, donacionet prej 207,355€, dhe Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 03/239 prej 324,412€.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	10,200,510	11,361,030	11,041,411	9,376,389	7,702,313
Pagat dhe mëditjet	5,604,111	5,929,379	5,926,455	5,295,789	4,308,370
Mallrat dhe shërbimet	1,133,279	1,469,746	1,398,678	1,190,007	987,545
Komunalitë	220,000	220,000	219,445	252,649	202,234
Subvencionet dhe transferet	350,000	500,412	449,388	313,059	182,839
Investimet Kapitale	2,893,120	3,241,492	3,047,445	2,324,885	2,021,325


Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 325,268€ me Vendim të Qeverisë së Kosovës nr. 03/239 i datës 24.12.2024.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 336,467€ nga kjo vlerë: 336,120€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 dhe 347€ rritje nga donacionet.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 150,412€ nga nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 348,372€ nga kjo vlerë: 142,220€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 dhe 206,152€ rritje nga donacionet,

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024 ishin 569,700€, përderisa ishin realizuar 558,033€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Të hyrat e grumbulluara nga institucionet nga niveli qendror që u shpërndahen komunave për vitin 2024 janë Gjobat nga trafiku në shumë prej 206,304€, Gjobat nga dënimet e trafikut në shumë prej 206,102€ dhe të hyrat nga agjencioni i pyjeve në shumë prej 202€ (këto të hyra nuk janë të përfshira në planin buxhetor të komunës).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	569,700	569,700	558,033	902,172	639,670
Të hyrat tatimore	313,004	313,004	221,528	332,448	278,662
Të hyrat jo tatimore	256,696	256,696	336,505	568,302	361,008
Të hyrat tjera	0	0		1,422	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për RFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me tetë (8) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, katër (4) rekomandime janë zbatuar, dhe katër (4) rekomandime nuk janë adresuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të plota dhe të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i plotë dhe i saktë. Gjithashtu, Kryetari duhet të sigurohet që zyrtarët përgjegjës të respektojnë afatet kohore për parashtrimin e kërkesave kreditore me rastin hyrjes së Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim nga Agjencia e Kosovës për Privatizim (AKP).	Janë ndërmarre veprime. Janë përmbushur kërkesat ligjore.	I zbatuar

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë menaxhim efikas të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, duke raportuar në raportet e tij gjashtë (6) mujore për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave nga shfrytëzuesit e pronës në raport me kushtet e përcaktuara në kontratë, në mënyrë që mos ju ipet prona palëve të treta për të cilat nuk e lejon legjislacioni në fuqi.	Janë ndërmarre veprime. Janë përmbushur kërkesat ligjore.	I zbatuar
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencione. Gjithashtu duhet të sigurohet që gjatë vlerësimit të aplikacioneve të respektohen kriteret e vendosura në thirrje.	Edhe këtë vit komuna ka bërë ndarja e subvencioneve duke mos respektuar kriteret e thirrjes publike.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara si dhe të gjitha projektet ekzekutuese të vendosen në platformën e-prokurimit.	Janë ndërmarre veprime. Janë përmbushur kërkesat ligjore.	I zbatuar
6.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të vazhdojë përpjekjet në bashkëpunim me MF për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për pagesat e parapara me kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuatë të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PVF sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.	Edhe këtë vit komuna ka regjistruar shpenzime në kategori ekonomike joadekuatë dhe si rezultat i kësaj kemi pasur keqklasifikime të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur mekanizma adekuat me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti, për vendosjen e mekanizmave për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatim

8.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Janë ndërmarre veprime. Janë përmbushur kërkesat ligjore.	I zbatuar
----	-----------------------	--	---	-----------


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit




Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	REPUBLICA E KOSOVËS KOMUNA E SHITIMES 16.06.2025	
KOMUNA SHTIME OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME			
16.06.2025 02/536			
LETËR E KONFIRMIMIT			
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve			
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit			
Të nderuar,			
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:			
• Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shitimes, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); • Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe • Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.			
Z. Qemajl Aliu			
Data: 13.Qershor.2025, Shitima			
			
			

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

